



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 8731/2018  
Data: 17.10.2018

**PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS**

Procesverbali nga mbledhja e nëntë - IX- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 27.09.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Fari Kalisi (drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Ajete Berisha (Udhëheqëse e Personelit), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i projekt-buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2020-2021 për komunën e Hani të Elezit.
3. Miratimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019.
4. Shqyrtimi i plotësimit dhe ndryshimit të statutit të komunës.
5. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
6. Miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të kompanisë publike lokale për mbeturina.
7. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.
8. Pyetje dhe përgjigje.

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

**Florim Shkreta thekson:-** ku qëndron problemi për përgjigjet të cilat nuk më ipen ashtu siç i kërkojë unë. Pyetjen që ja kam parashtruar drejtoreshën për shëndetësi dhe përgjigja që më është dhënë është larg realitetit. Drejtorisë për urbanizëm i parashtrova pyetje me shkrim dhe u përgjigj dhe është mirë ta praktikoni edhe ju praktikën e drejtorisë për urbanizëm. Për të njëjtat pyetje përsëri kërkoj përgjigje. Informacion me shkrim për listën e pagave të punëtorëve të QKMF-së. Për orët shtesë të stafit të QKMF-së. Kërkojë edhe nga kryetari i komunës të përgjigjet në pyetjet të cilat ja kam parashtruar dhe kërkoj të dijë se pse nuk më ipen përgjigjet. Kam kërkuar me u bashkangjitur ftesa zyrtare se ku keni qëndruar dhe me kënd jeni takuar për nderë të ditës së njëzet e tetë nëntorit të vitit 2017. Kur është pranuar pedagog z.Irfan Qajani dhe sa ka qëndruar si drejtorë i DKA-së. Kërkoj listën e personave të cilët kanë marr mëditje për datën njëzet e tetë nëntorit të vitit 2017.

**Kryesuesi thekson:-** çështjen e përgjigjeve mund ta diskutoni në pikën e fundit të rendit të punës të cilën e kemi sepse jemi duke diskutuar për pikat e rendit të ditës. Në momentin që vjen radhë për me diskutuar pikën e fundit të rendit të punës përsëri e ke mundësin për me i paraqitur.

**Florim Shkreta thekson:-** çdo herë e kam respektuar rendin e punës por ju po më detyroni me fol për shkak se çdo herë kam pritë në pikën e fundit.

**Kryesuesi** thekson:- përgjigjet të ipen me shkrim dhe ekzekutivi përgjigjet siç mendon, e jo sikur i donë t'i. Mund t'i kërkosh përsëri dhe është problem i ekzekutivit se si përgjigjet.

**Nuriman Kuka** thekson:- kërkoj informacion nga kryetari i komunës për çështjen e fushës së futbollit.

**Akif Shkreta** thekson:- unë e kam rendin e punës dhe pe shohë që rendi i punës nuk po përshtatet me atë se çka po bisedohet sot. Ne kemi një rend të punës dhe çdo temë tjetër që duhet të diskutohet është te të ndryshmet. Kryesues duhet ta respektojme këtë rend të punës. Nëse fillojmë me tema të tjera është në kundërshtim me rendin e punës, andaj fillojmë me rendin e punës i diskutojmë pikat e rendit të punës dhe në momentin që diskutojmë te të ndryshmet mund të diskutojmë.

**Mefail Suma** thekson:- kam vërejtje për pikën e gjashtë të rendit të punës që është miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të kompanisë publike lokale për mbeturina. Propozoj që në vend të shprehjes themelim të jetë formimi për shkak se kanë kuptime të ndryshme.

**Florim Shkreta** thekson:- deshta të ndërlihem me këshilltarët të cilët potencojnë se po e prishin rendin e punës mirë është me dhënë vërejtje kryetarit sepse ndodhë te unë dhe pritet edhe te t'i dhe përgjigjet nuk mund me i dhënë siç donë ky.

**Kryesuesi** thekson:- kërkoj që të përqendrohemi në rendin e punës për shkak se mund tu a ndërpresë fjalën dhe tu a tërheq vëmendjen dhe vërejtjen andaj fjalën ja kaloj z.Mehmet Ballazhi.

**Mehmet Ballazhi** thekson:-nga një herë po bimë në situata të pa lakmueshme dhe të pa nevojshme kësi soi. Nuk e dim se pse problemet duhet me i tejkaluar në mënyra të tilla kur ka mundësi në mënyra tjera. Ndërhyrje të ndryshme të panevojshme sikur z.Akif Shkreta që potencon se duhet të përqendrohemi në rendë të punës por edhe kjo çështje është në kuadër të rendit të punës dhe në rend të punës nuk është paraparë të diskutohet të ndryshme. Nëse parashtrohet një pyetje dhe kërkohet një përgjigje por pyetjet kërkohen në atë mënyrë që përgjigja me qenë e saktë dhe e dëshirueshme për atë të cilin parashtron pyetje. Nëse një këshilltarë ka parashtruar pyetje dhe përgjigja nuk është e kënaqur nuk do të thotë që përgjigja të jetë siç dëshiron ekzekutivi apo kryetari në këtë rast. Nëse kërkohet një ftesë zyrtare që ishin në vizitë nuk ka ndonjë problem dhe pse shmangët kjo që do të thotë të lenë me dyshuar se ka ndoshta keq përdorim të buxhetit. Ndoshta nuk ka keqpërdorim po të lenë me dyshuar dhe për atë më mirë është të jepni përgjigjen për ato pyetje dhe kryhet e nuk parashtrohet në çdo mbledhje. Un kam parashtruar pyetje dhe kam kërkuar që të më ipet përgjigja me emër dhe mbiemër apo me numra se sa janë me kontrata në vepër dhe në pyetje kanë potencuar që ka punëtorë me kontratë në vepër por nuk e kanë përcaktua se sa janë dhe për sa kohë kanë punuar. Nëse vazhdohet në këtë mënyrë sinqerisht them që e lëshojmë këtë mbledhje me tërheqje të vërejtjes që të jeni më konsekuenten dhe më seriozë në dhënien e përgjigjeve dhe bashkëpunimin me opozitën. Ju mos bashkëpunoni me opozitën por me qytetarët të cilët ne i përfaqësojmë për shkak se qytetarët janë të njëjtë për ju e nuk janë të ndarë pozitë dhe opozitë. Kërkoj që të jeni seriozë dhe mos të na bini në situata të tilla .

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për rendin e punës , nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

##### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

## **2. Miratimi i projekt-buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2020-2021 për komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- është mirë të diskutohet edhe një pikë e veçantë ridestnimi i mjeteve financiare për shkak se në disa projekte kemi mungesë të mjeteve financiare dhe duhet ta bëjmë një harmonizim të këtyre ku ka minus dhe ku ka plus. Është muaji i fundit që mundemi me bërë sepse në muajin tjetër nuk kemi mundësi për shkak të afatit ligjorë që e kemi për zotimet.

**Rufki Suma** thekson:- për çdo vit duhet të ketë rishikim të buxhetit dhe në këtë vit nuk ka pas rishikim të buxhetit dhe pasi nuk ka pas të gjitha ato mjete financiare që i kemi pas të planifikuara në disa projekte mund të shkojnë suficit. Nëse nuk ka rishikim ligji e lejon që me pas ridestnim të mjeteve financiare andaj propozoj që të diskutohet si pikë shtesë.

**Mefail Suma** thekson:- shkresa është e protokolluar kurse propozim vendimi jo, çfarë numri do të merr propozim vendimi pasi të miratohet.

**Shabi Rexhallari** thekson:- pasi të miratohet në kuvendë numri i shkresës i qitet vendimit.

**Kryesuesi** thekson:- pasi që drejtori u vonuar duke e përgatitur pikën shtesë të rendit të punës, andaj propozoj që të diskutohet pika e dytë e rendit të punës dhe pas kësaj pikë të diskutojmë për propozim vendimin për rialokimin dhe transferin e mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale. A keni ndonjë diskutim sa i përket këtij materiali shtesë, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**Shabi Rexhallari** thekson:- është shtuar një projekt në kuadër të drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, ndërtimi i shtëpive dhe banesave për banim social në shumë prej 15000 € dhe mjetet financiare janë marr nga projekti i ndërtimit të qendrës kulturore. Nëse keni edhe ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

### **U MIRATUA PROJEKT BUXHETI PËR VITIN 2019 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2020-2021 PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT**

## **3. Miratimi i propozim vendimit për rialokimin dhe transferin e mjeteve në kategorinë shpenzime kapitale.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- kemi transfer dhe rialokim të mjeteve në kategorinë e investimeve kapitale. Rialokimi do të jetë në shumë prej 105 097.00 € nga grandit qeveritarë dhe nga të hyrat vetanake. Materialin e keni para vetës dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- po e krahasojë ndërtimin e parkingut me ndërtimin e një shtëpie të cilën bëhet vetëm ndërtimi i vrazhdët dhe po më doket kosto e lartë ndërtimi i parkingut. Kërkoj sqarim se si do të bëhet ndërtimi i këtij parkingu.

**Teuta Shkreta** thekson:- a është ndërmarr diçka sa i përket largimit të punëtorëve të cilat ishin të punësuar me kontratë përmes Karitasit në QKMF. Duhet të ndërmerret diçka sepse është urgjente për të mirën e qytetarëve për shkak se nuk mund të mbulohen shërbimet as në QKMF as në terren.

**Akif Shkreta** thekson:- është planifikuar pak ndarja buxhetore për drejtorinë e zhvillimit ekonomik në shumë prej 23196.00 € dhe e njëjta kosto është edhe te shërbimet sociale 22707.00 €. Këto dy dikastere mendoj që duhet të mbulohen më shumë me mjete financiare sepse e dimë gjendjen sociale se si e kemi këtu dhe zhvillimi ekonomik është i vetmi dikasterë i cili mund ta zbutë papunësinë. Është mirë të rishikohet dhe të planifikohen më shumë mjete financiare.

**Rufki Suma** thekson:- bëhet fjalë konkretë për pronat e ish armatës aty ku është tregu dhe dua me ndërtuar një parking për kamionin e mbeturinave dhe mjeteve të tjera. Po të fillon nga fillimi do të kushton më shumë por ne vetëm do ta rregullojmë kulmin dhe riparimet e tjera, mi hap dyert e hyrjes dhe afrësishtë është planifikuar ajo shumë. Kërkesë kemi bërë te zyra Japoneze për kamionë të mbeturinave dhe kusht e kanë për me ndihmuar me pas garazhin dhe për atë arsye janë planifikuar këto mjete financiare. Nuk do të thotë që vetëm me ato mjete financiare bëhet zhvillim e ekonomik por edhe me i krijuar kushte në të bërit biznes është zhvillim ekonomik sepse prej kategorisë për bashkë investime shumica e mjeteve shkojnë për zhvillim ekonomik në bashkëpunim me organizata të ndryshme. Sa i përket gjendjes sociale nëse duam me i ndihmuar dikujt duhet përmes kategorisë për subvencione. Mungesën e stafit në QKMF e kemi plotësuar përmes punëtorëve me Karitasë mirëpo auditori ka potencuar që është keq klasifikim i buxhetit për shkak se nuk keni të drejtë prej projekteve kapitale me bërë këtë përmes Karitasit. Kërkesë kemi bërë në Ministrinë përkatëse për shtim të numrit të punëtorëve dhe nëse Ministria përkatëse nuk na e lejon shtimin e numrit të punëtorëve do të jemi të detyruar me pranuar punëtorë me kontrata në vepër për shkak se formë tjetër nuk kemi. Me Ministrinë e planifikimit hapësinorë kemi bërë marrëveshje dhe na i kanë lejuar shumën në vlerë prej 50 000 € në emër azbest çimentos dhe në kuadër të asaj ka qenë fusha e futbollit të cilën e kanë dëmtuar. Pasi që kjo shumë është e vogël kemi bërë marrëveshje edhe me Ministrinë e Kulturës në vlerë prej 50 000 € dhe komuna ka me i zhvilluar procedurat e tenderimit për këtë çështje.

**Sabedin Hasallari** thekson:- është planifikuar ndërtimi dhe rregullimi i rrugës Gorancë-Krivenik dhe kërkoj që kjo rrugë të lidhet edhe për te lagja e Hasallarëve.

**Rufki Suma** thekson:- nuk do të shtrohet me asfalt por rruga Gorancë-Krivenik në këtë vit është tu riparuar vetëm me zhavorr. Ne e kemi kodin riparimi i rrugëve dhe brenda mundësive që i kemi në të ardhmen mund ta bëjmë.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

#### U MIRATA PROPOZIM VENDIMI PËR RIALOKIMIN DHE TRANSFERIN E MJETEVE NË KATEGRONINË E SHPENZIMEVE KAPITALE

#### 4. Miratimi i rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi** thekson:- rregullorja i ka kaluar procedurat ligjore dhe në debat publik kemi pas dy propozime njëri ka qenë për kompanitë e suvatimit 150 € ta kenë taksën vjetore , dhe terminali doganorë ka propozuar që taksa të jetë 1500 €. Si drejtori nuk jemi që taksa të jetë 1500 € por mendojë që me ju bërë një zbritje në shumë 5000 €.

**Akif Shkreta** thekson:- propozoj që certifikata e vdekjes të jetë pa pagesë. Pika 4.2.9 dërgimi i dokumenteve jashtë Kosovës nga 2 € propozoj të jetë 5 €. Pika 4.2.13 përpilimi dhe lëshimi i aktvdekjes propozoj të jetë pa pagesë. Pika 4.2.25 propozoj që të jetë pa pagesë dëshmia e vdekjes. Pika 9.3.1 për regjistrim të vitit 100 € kërkoj sqarim. Pjesa gjashtë shitoret për shitjen e prodhimeve bujqësore propozoj që të jetë pa pagesë. Pika 16.3 propozoj që taksa të jetë në shumë 600 € por për ato banka të cilët kanë punëtorë. Për bankomatet propozoj që taksa të jetë në shumë 600 €. Pika 16.3.2 propozoj që të bëhet zbritje për kompanitë e pastrimit. Hapja e bizneseve të reja tre deri në pesë vite është pa pagesë dhe personi i cili pe mbanë pesë vite pa pagesë të njëjtin biznes po ja bartë dikujt tjetër apo ndonjë familjare dhe përsëri pesë vite pa pagesë. Vakumi ligjorë po

kalon në një lloj keqpërdorimi. E njëjta çështje është edhe për bizneset që i kanë selitë jashtë Hanit të Elezit dhe të cilët i kanë filialet në Han të Elezit është e njëjta çështje.

**Kryesuesi** thekson:- disa taksa që u propozuan mendoj se janë të rregulluara me ligj apo me udhëzime administrative.

**Fari Kalisi** thekson:- certifikatën e vdekjes mundemi me bërë pa pagesë kurse tjerat propozoj që mos me hekë pagesë.

**Akif Shkreta** thekson:- unë mendojë certifikatën e vdekjes me bërë pa pagesë dhe me rritë taksën për dërgimin e dokumenteve jashtë vendit.

**Rufki Suma** thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar edhe më herët por mendoj se janë të rregulluara me ligj sepse ne kemi bërë zbritjen dhe ngritje e taksës në disa prej tyre dhe Ministria përkatëse ka potencuar se këto janë të rregulluara me udhëzim administrativ dhe nuk mund të bëjmë zbritje apo ngritje.

**Kryesuesi** thekson:- këto taksa janë të rregulluar me ligj dhe udhëzime administrative dhe nëse bëhet ndërhyrja nga ana e jonë Ministria e kthen në rishqyrtim.

**Nora Xhoni** thekson:- nga praktika e mandatit kaluar dhe në trajnimet që kemi pas na kanë sugjeruar që në këto taksa mos me bërë ndryshime për shkak se janë të rregulluara me ligj dhe udhëzime administrative.

**Mefail Suma** thekson:- regjistrimi i më vonshëm në librat e gjendjes civile është hijezuar me ngjyrë të kuqe dhe është në shumë 100 €. Regjistrimi i më vonshëm në librat e gjendjes civile është në shumë 20€. Kërkoj sqarim për këto shuma që janë shënuar.

**Kryesuesi** thekson:- të gjitha taksat që janë hijezuar me ngjyrë të kuqe hiqen, kurse taksat që janë hijezuar me ngjyrë të verdhë janë propozuar për miratim. Në KPF është diskutuar çështja e regjistrimit për taksën e automjeteve që është në shumë 10€, mirëpo drejtori për buxhet dhe financa ka potencuar që kjo taks është e rregulluar me ligj.

**Shabi Rexhallari** thekson:- të gjitha komunat këtë tarifë e kanë të njëjtë dhe propozoj që mos të ndryshohet për shkak se është një vlerë në shumë prej 15 000 € të hyra vjetore prej kësaj takse. Në momentin që ndryshohet kjo taksë ndryshon edhe inkasimi dhe nëse zvogëlohet kjo shumë shtrohet pyetja se cilën taks me ngrit.

**Sevime Laçi** thekson:- propozimi që u dha për bankomatet që nga shuma 500 € me u ngritë në shumë 600€. Taksa aktuale që është në shumë 500 € mendoj që mufatonë për shkak se nëse shkohet vazhdimisht duke u rritur mund të ndodhë që bankat t'i tërheqin bankomatet dhe detyrohen qytetarët që me shkuar në Kaçanik apo në Ferizaj për me bërë tërheqje të parave.

**Akif Shkreta** thekson:- ne e dimë sa banka i kemi në Han të Elezit dhe NLB banka është e vetme që e ka rritur numrin e klientëve dhe kryen shërbime në sportele dhe është korrekte. Kurse Prokredit Banka dhe Raifaisen Banka kanë krijuar klientë e i kanë mbyllur bankat dhe i kanë lënë vetëm bankomatet që do të thotë se për qytetarin nuk është mirë.

**Kryesuesi** thekson:- ne e kemi diskutuar çështjen e kompanisë “Sharrcem” në KPF dhe vitet e kaluara e kemi pas një marrëveshje që brenda vitit 60 000 € me i ndarë për komunitete dhe bordi që është i themeluar nga komuna me ja shpërndarë komunitetit. Edhe pse marrëveshja ishte që 60 000 € brenda viti me i ndarë asnjë herë nuk ju ka përmbajtur marrëveshjes dhe ka rënë 10 000 € deri 20 000 €. Në këtë vit ka sugjeruar që vetëm 10 000 € do t'i ndanë për ndihmë komunitetit. Ne e diskutuam që me ja ngritë taksën sepse vendimet e veta të cilat i marrin te na nuk ju përmbahen. Ju njoftoj se “Sharcemi” bordin të cilin e ka krijuar për ndihmë komunitetit gati në shuarje e ka sepse me 10 000 € asnjë sektorë nuk mund ta financojmë.

**Akif Shkreta** thekson:- edhe më herët unë isha kundër këtij bordi për shkak se politikat e “Sharrcemit” ishin se që me i zhvendosur problemet dhe kërkesat e qytetarëve me potencuar se nuk merrem me këtë temë. Nëse keni bërë marrëveshje që me i ndarë kompania “Sharrcem” shumë prej 10 000 € nuk mendoj që është e mirë dhe “Sharrcem” nuk duhet me krijuar bord ndër komunal dhe bordi ndër komunal pastaj me bërë listë dhe me u marrë me problemet e tjera , mirëpo ne e kemi taksën dhe veprimet në kuadër të asaj takse. Marrëveshje mund të bënë komuna që “Sharrcemit” me mbështetur një klub futbollistik. Si kuvend mund të dakordohemi në nivel të shfave të grupeve parlamentar dhe me biseduar me kompaninë në fjalë në mënyrë që me ja hekë një barrë komunës duke i financuar klubet sportive

**Nora Xhoni** thekson:- unë mendoj që ne duhet ta paralajmërojmë për këtë çështje kompaninë “Sharrcem” dhe nëse nuk vepron mund të ja ngrisim taksën.

**Nuriman Kuka** thekson:- ne e dimë shumë se si ka qenë më herët por është mirë që edhe përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” me u deklaruar se pse e kanë ndërprerë këtë shumë.

**Mefail Suma** thekson:- terminali doganorë taksën vjetore e ka në shumë prej 80 000 € , kurse kompania “Sharrcem” 40 000 €, mirëpo a e njoftojnë komunën se sa kanë realizim brenda vitit të hyra financiare. Mendoj që aty ku ka të hyra nuk është mirë me ja falë duke u bazuar në atë që me pas mbështetje ligjore dhe përkrahje nga kuvendi i komunës.

**Zaim Bela** thekson:- në momentin që është arritur marrëveshja përmes bordit është formuar edhe shoqata Lab dhe në përmes të kësaj shoqate për çdo vit mbi 100 000 € është komuniteti jonë që po e shfrytëzon. Në bazë të informatave që i kam afër 78 biznese janë krijuar përmes “Sharrcemit”. Mjetet financiare që janë dhënë te rruga e lagjes re janë ndarë prej projekteve të labit që ishin për me i financuar fermerët.

**Kryesuesi** thekson:- në debat publikë është propozuar që kompanitë e suvatimit të kenë taksën në shumë prej 150 €. Propozimin e hedh në votim rezultati i votimit ishte 11 për 1 abstenim. Në debat publikë është propozuar që të jetë 1500 € , kurse drejtoresha për zhvillim ekonomik propozon që kjo taksë të jetë në shumë 5000 €. Propozimin e ekzekutivit e hedh në votim që terminali doganorë taksën ta ketë në shumë 5000 € rezultati i votimit ishte njëzëri.

**Mallzum Qajani** thekson:- për propozimet të cilat i ka paraqitur z.Akif Shkreta është se ato kanë të bëjnë me shpenzimet që i bënë komuna për ta lëshuar atë taksë dhe këto janë tarifa të cilat janë në nivel të vendit. Me që është tarifë unike unë nuk kisha potencuar që të hiqet sepse komuna i kryen shpenzimet e varrimit.

**Akif Shkreta** thekson:- nëse e precizon ligji që duhet të jetë me pagesë e përcakton edhe një shumë. Pasi shpenzimet varrimit hiqen ne të bëhet edhe certifikata pa pagesë.

**Bajrush Laçi** thekson:- ekziston udhëzimi administrativë për shkak se këto janë shërbime të gjendjes civile dhe të gjitha janë të përcaktuara me udhëzim administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

**Sevime Laçi** thekson:- sa i përket propozimit për shitore për shitjen e prodhimeve bujqësore por vetëm e kemi përcaktuar si taksë sepse nuk ka shitore në Han të Elezit.

**Mallzum Qajani** thekson:- nëse dikush e hap një shitore dhe shet prodhime bujqësore ai bënë tregti dhe është i barabartë me shitoret e tjera. Prodhuesit tonë që shesin qoftë në trotuare qoftë në pikën ku është rregulluar nuk ju marrin taksë.

**Akif Shkreta** thekson:- në rregullore kemi liruar ortarët, këpucëtarët në mënyrë që me vazhduar këtë veprimtari për shkak se po shkon drejtë humbjes kjo veprimtari. Unë mendoj që në Han të Elezit kemi që shesin prodhime bujqësore dhe mendoj që është ilegale po është mirë që komuna të jep një mundësi në këtë çështje për shkak se ka qytetarë të cilët kanë fermë të vetën për këtë çështje.

**Sevime Laçi** thekson:- në këtë veprimtari mund të ndodhë që të vijnë nga Ferizaj me hap shitore këtu për shitjen e prodhime bujqësore atëherë a do ta lironi nga taksa.

**Nora Xhoni** thekson:- në qoftë se hapet një veprimtari e tillë do të punon katër stinore , kurse shitësit të cilët shesin në rrugë janë vetëm një stinore dhe dallon shumë.

**Kryesuesi** thekson:- propozimin për me hekë taksën për prodhimet bujqësore e hedh në votim rezultati i votimit ishte 10 për 1 abstenim.

**Akif Shkreta** thekson:- bankat propozoj që të taksën ta ketë 700 € dhe këtu e kemi NLB e cila i ka mbajtur punëtorët dhe nuk i ka larguar nga puna.

**Mallzum Qajani** thekson:- taksat komunale bëhen sipas veprimtarisë dhe nuk dallohen subjektet afariste qoftë bankë apo diçka tjetër. Nëse NLB-ja dhe Rajfaizen banka kanë filiale duhet të trajtohen njëjtë. Po ashtu cila do bankë që ka bankomatë duhet të trajtohet njëjtë për bankomatet dhe nuk mund të bënë dallime komuna në banka për të njëjtën veprimtari. Në kuptim të ligjit nuk mund të bëjmë dallime të tilla. Nëse shkohet në zbritje duhet të jetë një përqindje zbritja dhe të ketë një arsye se pse kemi bërë zbritje në përqindje të një kategorie. Rregull është që taksa të përcaktohet në bazë të veprimtarisë e jo në bazë të subjekteve përkatëse afariste.

**Akif Shkreta** thekson:- edhe Rajfaizen banka i kryen të njëjtat shërbime dhe nëse është kështu nuk prishë punë.

**Sabedin Hasallari** thekson:- propozoj që mos të bëhet zbritje për Bankat për shkak se për një faturë me bërë pagesë tri euro e kanë shërbimin. Është mirë që mos të brengosemi se bankat i kanë fitimet shumë më të madhe se sa po merremi ne me disa sende të vogla. Ndoshta është e tepërt sepse do të kisha propozuar me ua rrit taksën për shkak se për interesa të veta i kanë hapur këtu, kurse disa të cilat nuk e kanë parë interesin e vetë janë tërhequr.

**Nora Xhoni** thekson:- propozoj që taksa për bankat me mbetur ashtu siç është.

**Kryesuesi** thekson:- po e shohë që ekziston vullneti që propozimin për bankat mos me hedhë në votim për shkak se vërehet që të gjithë jeni që me mbet ashtu siç është. Në Mbledhje të KPF-së z.Mehmet Ballazhi ka kërkuar që taksa për regjistrim të automjeteve të zbritet.

**Shabi Rexhallari** thekson:- ne si drejtori kërkojmë që taksa me mbetet ashtu siç është.

**Mallzum Qajani** thekson:- kjo taksë ka një implikim shumë të madh në inkasimin e të hyrave vetanake sepse me këtë taksë mund t'i themi qytetarit që nëse ke mjete financiare me paguar regjistrimin e veturës duhet ta paguani edhe tatimin në pronë dhe obligimet e tjera që i ke ndaj komunës. Nuk ka kuptimi t'i themi qytetarit që nuk t'i japim dokumentet themelore nëse nuk e ke paguar tatimin në pronë. Nëse qytetari kërkon taksën për regjistrimin veturës këto janë pikat që komuna kërkon nga qytetari për me i kryer obligimet që i ka ndaj komunës. Kjo taksë nuk e rëndon shumë gjepin e qytetarit.

**Mefail Suma** thekson:- nëse qytetari i ka të kryera obligimet ndaj komunës pse me i marr taksë atëherë kjo i bien si kusht.

**Mallzum Qajani** thekson:- ajo veturë që regjistrohet në komunën tonë dhe paguan taksë e shfrytëzon edhe infrastrukturën komunale. Unë mendoj që nuk është një shumë e madhe për një qytetarë i cili ka veturë që një herë në vit me kryer një pagesë në shumë prej 10 € në komunë nuk besoj që e rëndon buxhetin.

**Kryesuesi** thekson:- propozimin e z.Mehmet Ballazhi e hedhe në votim, rezultati i votimit ishte 2 për 1 abstenim 9 kundër. Në tërësi e hedh në votim rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba komunale për vitin 2019, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

## U MIRATUA RREGULLORJA PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE PËR VITIN 2019

### 5. Shqyrtimi i plotësimimit dhe ndryshimit të statutit të komunës.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- statuti i komunës nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh është rikonsturim i atij që ka qenë më përpara. Ndryshimet janë kryesisht te kompania publike për mbeturina dhe te komitete konsultative. Nëse keni ndonjë vërejtje apo propozim mund të parashtroni.

**Akif Shkreta** thekson:- neni 27 anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë të obliguar të paraqesin konfliktet e interesit në pajtim me dispozitat e nenit 38 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Nëse Kuvendi i komunës ose komiteti gjatë shqyrtimit të çështjeve të caktuara, konstaton ekzistimin e konfliktit të interesit të ndonjë anëtari, vendos me shumicë votash të anëtarëve prezent për përjashtimin e tij nga procesi i vendimmarrjes. Çka ka të bëjë me shumicë të votave kur kjo është çështje ligjore.

**Bajrush Laçi** thekson:- kjo është e përcaktuar me nenin 38 të ligjit për vetëqeverisje lokale. Dispozita tjetër e përcakton sepse ka ndonjë anëtarë të kuvendit të komunës i cili nuk donë me treguar konfliktin e interesit dhe anëtarët e kuvendit kanë të drejtë që me shumicë të votave me përjashtuar nga vendim marrja.

**Akif Shkreta** thekson:- në qoftë se nuk kalon në vota ai faktikisht përsëri është pjesë e konfliktit të interesit.

**Bajrush Laçi** thekson:- është dispozitë decidive për shkak se nuk ka diçka që të lejon dhe kjo ta ndalon që do të thotë se me shumicë votave konstatohet konflikti i interesit dhe pastaj vendoset me shumicë të votave të anëtarëve të kuvendit për me përjashtuar nga procesi i vendimmarrjes nëse ai nuk e deklaroi konfliktin e interesit.

**Mefail Suma** thekson:- te neni 9 potencohet që komuna i ka vulat e veta dhe përmendet vula e rrumbullakët dhe vula katrorë. Kërkoj sqarim se a është vula katrore apo katër këndësh. Neni 46 shënon njoftimi i drejtorive kryetarit e komunës , mendoj që nuk tingllonë ëmbël kjo fjali, unë në këtë fjali mendoj që duhet ta përshtatni më mirë. Neni 55 betimi nuk është i përputhur me anën gjuhësore për shkak se gjatë udhëheqjes së seancës për inaugurimin e kuvendit të komunës gjatë shqiptimit të fjalëve unë betohet e kam vërejtur se nuk e ka atë muzikalitetin dhe nuk lenë pushim për frymëmarrje. Fjala është edhe për betimin e kryetarit të komunës dhe për betimin e anëtarëve të kuvendit të komunës. Unë mendoj që duhet të jetë kështu betimi i kryetarit të komunës. Betohem si kryetarë i komunës së Hanit të Elezit se do ty kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia me nderë besnikëri paanshmëri me ndërjegje dhe në pajtim me ligjin në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë. Opsioni i dytë është se unë si kryetarë i komunës së Hanit të Elezit betohem se do ty kryej detyrat dhe do të ushtroj kompetencat e mia dhe vazhdon me tutje. Po ashtu edhe betimi i anëtarëve të kuvendit të komunës duhet të jetë: betohem si anëtarë i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit se do ty kryej me nderë besnikëri pa anime dhe vazhdon tutje teksti si është.

**Bajrush Laçi** thekson:- ligji e përcakton që komuna e ka vulën rrethore dhe vulën katrore. Janë të përcaktuara me ligj se çka përmban vula katrore dhe vula rrethore. Neni 55 e përcakton betimin e kryetarit të komunës që është nxjerr prej ligjit dhe nuk kemi shtuar asgjë sepse ashtu e parasheh ligji. Neni 46 precizon që drejtorët duhet ta njoftojnë kryetarit e komunës për veprimet që marrin.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

## U VOTUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I STATUTIT TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK

## 6. Miratimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019

**Kryesuesi** thekson:- komisioni ka mbajtur takim për këtë pikë të rendit të punës dhe ekzekutivi i komunës ka kërkuar që tri pika të rendit të punës të hiqen nga diskutimi i planit të punës dhe si komision nuk e kemi vendosë por jemi dakorduar që në kuvend me biseduar. Pika të cilat kërkon ekzekutivi mu hekë nga rendi i punës janë: informatë e progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit, raporti monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak, informatë mbi realizimin e planit të prokurimit për vitin 2019. Drejtorja për buxhet dhe financa ka kërkuar që informata e progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit të hiqet për arsye se nuk kemi auditorë të brendshëm dhe nuk mund të përgatisim material për këtë pikë të rendit të punës. Drejtorja për urbanizëm kadastër dhe mbrojtje të mjedisit ka kërkuar që të hiqet pika raporti monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak për arsye se është duke u bërë hartimi i plani të ri. Ekzekutivi ka kërkuar që informatë mbi realizimin e planit të prokurimit për vitin 2019 të hiqet nga plani i punës për vitin 2019 me arsyetim se kjo pikë hynë te raporti i punës së kryetarit të komunës. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlasi** thekson:- informata mbi suksesin e arritur të nxënësve në SHFMU dhe SHML në fund të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2018-2019 tash me kurikulën e re janë tri perioda të notimit dhe propozoj që të hiqet kjo.

**Kryesuesi** thekson:- planin e punës së kuvendit të komunës e hedhë në votim me këto propozime, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

### U MIRATUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2019

## 7. Miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve të kompanisë publike lokale për mbeturina.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- te përmbajtja e vendimit mungon mandati edhe pse ndoshta është e precizuar me ligj por të gjithë nuk e dimë ligjin. Nuk janë të përcaktuara punët dhe detyrat e komisionit.

**Akif Shkreta** thekson:- a janë të shënuara kriteret që numri më i madh i asamblistëve të vendosë për propozimet e tilla. Nëse në ligj shënon që pozita në llogaritmi pjesë e pozitës pavarësisht numrit të asamblistëve.

**Kryesuesi** thekson:- në mandatin e kaluar kemi shkuar në këtë mënyrë dhe po mendojë që kjo mënyrë funksionon dhe ju mund të diskutoni në nivel të shefave.

**Nora Xhoni** thekson:- në KPF u dakordua që dy partitë të cilat kanë ulëse më shumë me i përcaktuar emrat për anëtarë të komisionit.

**Akif Shkreta** thekson:- në KPF kryesuesi i kuvendit potencojë që vendosë pozita për këto dy emra.

**Kryesuesi** thekson:- kam potencuar që vendosë pozita për këto dy emra por e kam potencuar që në mandatin e kaluar në këtë mënyrë kemi vepruar.

**Nora Xhoni** thekson:- në emër të grupit parlamentarë të AAK-së propozoj z.Isni Bushi për anëtarë të komisionit.

**Samire Curri** thekson:- në emër të krupit parlamentarë të LDK-së propozoj z.Nuriman Kuka për anëtarë të komisionit.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim ; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

## **U MIRATUA PROPOZIM VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNA TË AKSIONARËVE TË KOMPANISË PUBLIKE LOKALE PËR MBETURINA**

### **8. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi thekson:-** të gjitha informacionet janë paraqitur në detale në material dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabedin Hasallari thekson:-** çka do të bëhet me objektet shkollore të cila nxënësit kanë kaluar në shkollën fillore “Ilaz Thaçi” në Han të Elezit dhe në shkollën fillore “Veli Ballazhi” në fshatin Gorancë. Sa do të jetë kostoja për bartje të nxënësve në këto shkolla.

**Menduh Vlashi thekson:-** jemi konsultuar me kryetarin e komunës dhe ekzekutivin e mbi të gjitha kemi arritur një marrëveshje me prindërit e fëmijëve që është shumë me rëndësi sepse kemi pas dëshirë që edhe paralelen e ndarë në fshatin Krivenik me transferuar në Han të Elezit por nuk kanë pranuar prindërit. Numri i nxënësve ka rënë jashtzakonisht shumë dhe e kemi njoftuar Ministrinë e arsimit për shkak se një klasë duhet t'i ketë dhjetë nxënës dhe nëse i ka më pak se dhjetë nxënës duhet të kombinohen klasa e parë me klasën e tretë. Në fshatin Rezhancë është mësuar në klasë të pa ndara nga klasa e parë deri në të pestën dhe atje nuk ka mësim por në biseda me prindërit jemi dakorduar mos me vazhduar kështu sepse fëmijët po kanë pasoja në mësim. Në biseda që kam pas me nxënësit dhe prindërit e fshatit Laç janë shumë të kënaqur. Nxënësit e fshatit Rezhancë kanë filluar nga dita e hënë dhe besoj që edhe ata do të jenë të kënaqur për këtë çështje. Nuk e kemi kalkuluar shifrën e mjeteve financiare për arsye se për mu personalisht nuk duhet të jetë parja kusht por kusht është me pas cilësi në mësim , mirëpo cilësi në mësim me klasë të kombinuara nuk ka. Nuk duhet të shikohet shumë kostoja financiare nëse është në pyetje suksesi i nxënësve. Objektet shkollore do të mbeten pronë e drejtorisë së arsimit dhe do të mirëmbahet nga komuna.

**Hanumshahe Dibrani thekson:-** është e domosdoshme që ne si prind të ju sigurojmë fëmijëve tanë diçka ushqim për me marr me vete, mirëpo më mirë do të ishte që komuna tu a siguron nga një shujtë nxënësve nga klasa e parë deri në klasën e pestë , në mënyrë që mos të jetë si brengë se me çka ushqehen dhe si ushqehen. Kjo do të ishte më e mirë për të gjithë sepse ua lehtëson gjendjen prindërve si problemë që është sepse një fëmijë ushqehet e një jo për shkak se të gjithë nuk kanë kushte për me ua siguruar fëmijëve të tyre për çdo ditë diçka për në shkollë. Nëse drejtorja e arsimit nuk mund tu a siguron ne si prind duhet të organizohemi dhe të paguajmë për nga një shuajt në ditë dhe tu ndihmohet edhe atyre që nuk kanë mundësi.

**Teuta Shkreta thekson:-** ndoshta është problem për drejtorin e arsimit kjo çështje por në mandatin e kaluar kam potencuar që nëse bëhet një gjë e tillë fëmijët janë të barabartë. Është mirë që të merret një vendim për të gjithë njëjtë qoftë komuna me participuar apo qoftë edhe prindërit. Fëmijëve parashkollorë sa gjërat i blejnë për shkak se secili prind mundohet me ju blejë diçka pavarësisht se dikush ka e dikush nuk ka. Problemi është që fëmija të jetë i barabartë.

**Akif Shkreta thekson:-** kjo çështje është diskutuar edhe më herët dhe në vitin 2007 e kemi pas një praktikë të tillë ku vetë prindërit kanë participuar nga tri euro për nxënës në mënyrë që me i mbuluar edhe ata të cilët nuk kanë, mirëpo kjo çështje ka zgjatë diku pesë apo gjashtë muaj dhe është ndërprerë. Është e mirë në se sigurohet dhe do të ishte mirë që nëpër shkolla me u bërë në formë bifeje dhe përgatitjet me u bërë aty. Drejtorja për arsim duhet ta analizon këtë çështje dhe duhet ta bisedon edhe në mbledhje prindërore dhe bashkarishtë me prindërit ta merr një vendim.

**Menduh Vlasi** thekson:- shembullin e dhënies së ushqimit e kemi në komunën e Prishtinës që me një mënyrë ka dështuar për arsye se ka pas vërejtje të ndryshme. Më kujtohen rastet kur filluan me sjellë kiflet dhe filluan me i gjuajt për shkak se një ditë dy apo tri ditë han kiflet pastaj nuk i hajn. Është shumë problem por është e mirë dhe do të konsultohem me drejtorët e shkollave dhe ata konsultohen me prindërit për arsye se buxheti i komunës nuk mund ta përballon.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 9. Pyetje dhe përgjigje.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- sot gjatë punimeve nëpër tekstet që i ka ndryshuar ekzekutivi e ka parë që të rregullorja për taksat dhe tarifa ka qenë ngjyra e kuqe, e verdhë dhe ngjyra e zezë. Te statuti ka qenë ngjyra e kuqe, ngjyra e kaltër dhe ngjyra e zezë. Te statuti nuk munda me kuptuar ngjyrën e kuqe dhe të kaltrën.

**Bajrush Laçi** thekson:- statuti është dërguar si projekt dhe nuk është diçka që është bërë dhe diçka që nuk është bërë. Në përmbajtjen e statudit mundesh me ndërhyjë prej fillimit deri në fund. Ata të cilat janë ndryshuar dhe që janë shtuar janë me ngjyra dhe në shkresë përcjellëse është dhënë sqarimi. Derisa është projekt statut mundesh me ndërhyrë ku të duash dhe nuk ka problem.

**Mefail Suma** thekson:- nga Hani i Elezit deri në vendin e quajtur Kashan uji rrjedh dhe tash koha bëhet e ftohet dhe mund të bëhet ngritsa dhe është mirë të del inspektori në vend ngjarje dhe ujërat të cilët kalojnë në asfalt me i ndaluar. Nuk dua askujt të ja ndalojë veprimtarinë por duhet të ndërmerret diçka. Komuna duhet t'i bënë një shkresë Ministrisë së Infrastrukturës që ta rregullon magjistratë sepse te ura e Kashanit është dëmtuar shumë dhe veturat po dëmtohen kurse ne si qytetarë po i paguajmë taksat kur po e regjistrojmë automjetin.

**Nora Xhoni** thekson:- para tri apo katër dite ka pas erëra të forta a është raportuar për ndonjë dëm që kanë shkaktuar

**Kryesuesi** thekson:- nuk ka pas ndonjë rast. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpallur të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:24.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**MSc. Qamush Brava**

